




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural



THIRRJE PËR APLIKIM

PËRKRAHJA E FERMERËVE ME SERRA

Njoftohen fermerët e komunës së Rahovecit se Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë për vitin 2024-2025, ka paraparë që të bëjë ndërtimin e Serrave me participim për kultivuesit e perimeve.

Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e serrës janë:

- Të jetë banor i Komunës së Rahovecit,
- Të jetë fermerë i regjistruar (NIF)
- Të ketë të shlyera obligimet ndaj Komunës (vërtetim i tatimit në pronë),
- Të jetë kultivues i perimeve,
- Të jetë i gatshëm të nënshkruaj marrëveshje me Komunën e Rahovecit dhe të marr përsipër participimin prej 20%

Kriteret specifike që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e serrës janë:

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kriteret specifike:

- Të jetë aplikues në Programin e Pagesave Direkte – Subvencione në vitin 2024
- Të ketë së paku **0.50 ha** të mbjellura me kultura Perimore (Spec, Domate, Tranguj, Lakër, etj),
- Të kenë qasje në sistem të ujitjes, apo të kenë të siguruar burime alternative të ujit
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë të bashkësisë familjare, të cilët kanë përfituar serrë në tri (3) vitet e fundit.

Përparësi në përzgjedhjen e fermerëve përfitues

- Në kushte të barabarta, përparësi përfitimi kanë fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët nuk kanë qenë asnjëherë përfitues nga komuna.
- Fermerët me sipërfaqe më të madhe në raport me ata që kanë sipërfaqe më të vogël të mbjellë me perime (spec, domate, sallatë të gjelbër, tranguj, lakër)
- Përparësi kanë fermerët që kanë të siguruar tregun (kontratë me qendrat grumbulluese dhe përpunuese të perimeve)
- Përparësi kanë gratë fermere
- Përparësi përfitimi kanë fermerët të cilët kanë qenë pjesëmarrës në aktivitetet me karakter bujqësor të organizuara nga Komuna

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

- Fleta poseduese e tokës - certifikata e pronësisë,
- Kopja e planit të parcelës ku do të vendoset Serra,
- Kopja e letërnjoftimit të vlefshëm të Republikës së Kosovës,
- Dëshminë mbi pagesën e tatimit në pronë.

Përzgjedhjen do ta bëjë komisioni i formuar pas mbylljes së afatit të aplikimit dhe do të formohet nga Kryetari i Komunës së Rahovecit,

Karakteristikat e përgjithshme për Serra:


1. Serra **300m²**, 50 copë
2. Serra **500m²**, 25 copë

Vërejtje:

- *Përkrahja do të jetë 80% nga Komuna e Rahovecit,*
- *Të jenë të gatshëm të kryejnë pagesën prej 20%*
- *Verifikimi i përzgjedhjes së përfitueseve do të bazohet në aplikacionet për Pagesa Direkte të vitit 2024*

Afati i aplikimit nga data: **17.09.2024** deri më **01.10.2024**

Aplikacionet dorëzohen në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

**Drejtori për BPZHR**

Berat Duraku